
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.218/19	Data: 10.09.2019	

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall:

KONKURS

Zyra e Kuvendit

Titulli i vendit të punës : Zyrtar i Lartë për Punë Profesionale për Kuvendin Komunal

Numri i Referencës : RN00005604

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Lloji i pozitës: I karrierës

Orari I plotë: 40 orë në javë

Kategoria Funktionale: Niveli Profesional

Grada: Niveli i koeficient (koeficienti 7.5)

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Kohëzgjatja e periudhës provuese : 12 muaj.

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve profesionale në përmbushjen e objektivave të Kuvendit

Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
2. Udhëheqë dhe koordinon aktivitetet në hartimin e projekt rregulloreve, projekt vendimeve për miratim në Kuvendin e Komunës në kompetencë të tij;
3. Siguron që projekt rregulloret komunale dhe aktet tjera juridike të jenë në pajtueshmërinë me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës;
4. Përgatit aktet juridike (vendime, urdhëresa, autorizime, pëlqime, marrëveshjeve, shkresa të ndryshme) për aprovim nga Kuvendi i Komunës;
5. Siguron përgatitjen e materialeve për takime të KPF-ës, Komitetit për Komunitet, Asamblesë Komunale, zyrës së Kryetarit dhe takimeve konsultative të drejtorëve;
6. Siguron që draft rregulloret komunale, vendimet dhe aktet tjera të jenë dërguar me kohë tek secili anëtar i kuvendit komunal dhe drejtor i drejtorive;
7. Mbanë dhe harton e procesverbalet nga takimet e Kuvendit Komunal, Komiteteve të Kuvendit Komunal dhe procesverbaleve të Komisionit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Komunës;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

Kushtet e pjesëmarrjes në Rekrutim :

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare, Fakulteti Juridik, minimum 3 vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore, juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Afati i konkursit : Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Dokumentet e kërkuara : Diploma mbi kualifikimin, diplomat e lëshuara nga institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i, dëshmi për përvojën e punës, certifikata që nuk jeni nën hetime origjinal, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (të punësuarit), si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës “

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen
- Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Mëfajsheri i Personelit
Fatmir Bytyci